

VENDIM
Nr.853 , datë 19.12.2003

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.309, DATË 15.5.2003 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE "PËR TRAJTIMIN E PUNONJËSVE TË ADMINISTRATËS SË ALBKROM
SHA, QË SHKURTOHEN NGA PRIVATIZIMI DHE DHËNIA ME KONCESION E
INDUSTRIË SË KROMIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 6 të ligjit nr.8562, datë 22.12.1999 "Për përcaktimin e formës dhe strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë anonime Albkrom" dhe të nenit 7 të ligjit nr.8334, datë 23.4.1998 "Për privatizimin e shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët jostrategjikë", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë dhe të Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 1 të vendimit nr.309, datë 15.5.2003 të Këshillit të Ministrave të bëhet ky ndryshim:

a) Fjalët "...të cilët shkurtohen gjatë vitit 2003..." zëvendësohen me "... të cilët shkurtohen deri në fund të vitit 2004..."

b) Në fund, pas fjalës "...Albkrom, sh.a-së, shtohet shprehja "...dhe të ardhurat e tjera, që sigurohen nga veprimtaria e shoqërisë, gjatë likuidimit.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano